



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prijmjenoh/Prodato Received/Delivery | 11.10.2023 | 3 viti god year | |
| Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shlycja Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKUMSHUK | 6510/2023 | | 115 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1128/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës A.nr.1128/2023 të datës 30.08.2023 të ankuesit Lulzim Krasniqi, i përfaqësuar nga Avokati me adresë:

kundër Vendimit me numër Ref: 411/2022 të Zëvendës/ Kryeministres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 30.06.2022, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 11.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e nisur sipas ankesës A.nr.622/2022 të datës 15.07.2022 të ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përmes përfaqësuesit të tij me datë 15.07.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit me numër ref:411/2022 të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të datës 30.06.2022 lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me pretendimet ankimore se me rastin e nxjerrjes së vendimit të ankimuar ka shkelje flagrante të dispozitave të procedurës administrative dhe dispozitave të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankuesit e ka proceduar me datë 25.07.2022 për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Këshilli, ndërsa Këshilli me datë 03.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Ankuesi, më pas ka hapur konflikt administrativ kundër Vendimit të Këshillit të datës 26.01.2023, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr.412/2023 të datës 17.08.2023 ka aprovuar kërkesëpadinë e palës paditës, e ka anuluar vendimin e Këshillit ndërsa lëndën e ka kthyer në rishqyrtim me kërkesën që Këshilli ta udhëzojë palën paditëse tek organi kompetente lidhur me kërkesën e saj për realizimin e të drejtës së tij në mjetet të rregullta juridike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.412/2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 17.08.2023; Procesverbalin e seancës të shqyrtimit kryesor të datës 17.08.2023; Përgjigjen në padi e datës 18.04.2023 me numër protokolli:3649/2023; Mendimin Mospajtues të datës 30.01.2023 me numër protokolli:1104/2023; Autorizimin e datës 16.08.2023; Ankesën e ankuesit të parashtruar me datë 15.07.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e protokolluar me numër:4149/2022; Autorizimin e datës 01.07.2022; E-mailin e datës 02.02.2012 dërguar nga [] për ankuesin dhe të tjerët; E-mailin e datës 07.02.2012 dërguar nga [] për ankuesin dhe të tjerët me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 30.01.2012 dërguar nga [] për ankuesin dhe të tjerët; E-mailin e datës 02.06.2012 dërguar nga Zyra e Personelit të MPJ-së për ankuesin; Njoftimin për pjesëmarrje në intervistën me gojë; E-mailin e datës 27.01.2012 dërguar nga Zyra e Personelit të MPJD-së për ankuesin; E-mailin e datës 09.02.2012 dërguar nga [] për [] E-mailin e datës 30.01.2012 dërguar nga ankuesi për Vendimin me numër ref:627/2013 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme i datës 30.12.2013; Vendimin me numër:ZSP-114/2016 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme i datës 20.09.2016; Akt emërimit e ankuesit të datës 08.11.2016; Vendimin me numër:ZSP-29/2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme i datës 14.03.2017; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit me numër Nr-203/2017 i datës 17.03.2017; Vendimin me numër ref:201/2018 i Zëvendës Kryeministrit dhe Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme i datës 30.03.2018; Vendimin me numër ref:738/2018 Zëvendës Kryeministrit dhe Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme i datës 26.11.2018; Notën Verbale të datës 11.09.2020 me numër prot:1694 dhe Ref: ZDP/112/2020; Vendimin me numër Ref:135/2022 të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 14.03.2022; Vendimin me numër Ref:104/2022 të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 02.03.2022; Vendimin me numër ref:411/2022 të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 30.06.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.07.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 03.08.2022; Vendimin me numër Ref:112/2022 të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 04.03.2022; E-mailin e datës 27.01.2021 dërguar nga [] dërguar në Këshill me korrespondencën e bashkangjitur; Vendimin e datës 21.07.2011 për shpalljen e konkursit nga Ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme; Listën e kandidatëve aplikues për misionë diplomatike e periudhës gusht 2011; Listën e kandidatëve aplikues për misionë konsullore e periudhës gusht 2011; Vendimin e Këshillit A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022; Mendimin Mospajtues nga anëtari i Kolegjit të Këshillit për Vendimin e Këshillit A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022; Vendimin e Këshillit A.nr.278/2020 të datës 16.11.2020; Vendimin e Këshillit A.nr.263/2022 të datës 19.04.2022; Vendimin e Këshillit A.nr.917/2021 të datës 29.12.2021; Vendimin e Këshillit A.nr.301/2021 të datës 20.05.2021; Ankesën e datës 28.07.2022 të parashtruar nga palët në Gjykatën e Apelit të Kosovës përmes Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me numër

A.nr.1687/2022; Vendimi i KPMSHCK A.nr.622/2022 e datës 29.08.2022; Dëshmit e pranimit të vendimit; Kërkesa për vendosje lidhur me ankesën e datës 07.12.2022; Aktvendimin A.nr.597/2022 të datës 25.08.2022; Aktvendimin A.nr.1687/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin me shifër ARJ-UZVP.nr.115/2022 të Gjykatës Supreme të datës 09.11.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore si dhe ekzistojnë rrethana të reja të cilat e plotësojnë kushtin që vendimmarrja për lëndën A.nr.622/2022 të ankuesit të *pezullohet, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi ka qenë i punësuar respektivisht e ka themeluar marrëdhënien e punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme sipas Vendimit me numër Ref:627/13 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme i datës 30.12.2022, ndërsa së fundi sipas Vendimit me numër Ref:135/2022 të Zëvendës/Kryeministres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 14.03.2022 i ishte vazhduar mandati të shërbejë në Konsullatën e Republikës së Kosovës në NewYork/SHBA me gradën diplomatike *Këshilltar* deri me datë 31.10.2022.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Zëvendës/Kryeministrja dhe Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes Vendimit me numër Ref: 411/2022 të datës 30.06.2022 e ka shfuqizuar aktin e themelimit të marrëdhënies së punës së ankuesit, respektivisht Vendimin me numër ref:627/13 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme i datës 30.12.2022, Vendimin me numër Ref:201/2018 i datës 30.03.2018 përmes të cilit ishte caktuar të shërbejë në Konsullatën e Republikës së Kosovës në NewYork/SHBA me gradën diplomatike *Sekretar i Par* dhe po ashtu e ka shfuqizuar edhe Vendimin me numër Ref:135/2022 të datës 14.03.2022 përmes të cilit ankuesit i ishte vazhduar mandati të shërbejë në Konsullatën e Republikës së Kosovës në New York/SHBA me gradën diplomatike *Këshilltar*.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me Vendimin Nr.ref: 411/2022 të datës 30.06.2022 ka shfuqizuar Vendimin më numër reference 627/2013 të datës 30.12.2013 lidhur me emërimin e ankuesit në Shërbim e Jashtëm Diplomatik të Republikës së Kosovës dhe caktimin e gradës diplomatike Sekretar i Parë, ku edhe ishte caktuar të Shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Republikën e Panamasë, po ashtu ka shfuqizuar edhe Vendimin me numër Ref:201/2018 i datës 30.03.2018 si dhe Vendimin numër ref:135/2022 i datës 14.03.2022, mbi bazën ligjore së emërimi i ankuesit në shërbime të jashtëm është bërë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr.03/L-022 për Shërbimin e Jashtëm, si dhe në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Pas trajtimit të ankesës së ankuesit të datës 15.07.2022, Këshilli përmes Vendimit me shenjë A.nr.622/2022 të datës 26.01.2023 është shpallur jo kompetentë, kurse ankuesi më pas ka hapur konflikt administrativ kundër Vendimit të Këshillit të datës 26.01.2023, ndërsa Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr.412/2023 të datës 17.08.2023 ka aprovuar kërkesëpadinë e palës paditës, e ka anuluar vendimin e Këshillit ndërsa lëndën e ka kthyer në rishqyrtim më kërkesën që këshilli ta udhëzojë palën paditëse tek organi kompetente lidhur me kërkesën e saj për realizmin e të drejtës së tij.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave thekson faktin se Këshilli përmes Vendimit me numër A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022 me shumicë votash kishte vendosur të shpallet jo kompetentë për të shqyrtuar ankesat e ankuesve:

dhe ndërsa për vendimin në fjalë njëri nga anëtarët e Kolegjit të Këshillit kishte paraqitur në formë të shkruar mendim mospajtues për natyrën e vendosjes i cili në Këshill është i evidentuar me shenjë A.nr.356/2022 i datës 10.06.2022 dhe numër protokolli:3386/2022. Andaj, bazuar në të dhënat me provat e bashkangjitura të dosjes së ankesave të ankuesve të bashkuara në ankesën A.nr.365/2022 dhe shkresave të lëndës së ankesës së ankuesit A.nr.622/2022, Kolegji i Këshillit konstaton se arsyet e dhëna në vendimet e Zëvendës/Kryeministres dhe Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ne rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të ankuesve të evidentuar sipas Vendimit të Këshillit me shenjë A.nr.365/2022 janë specifikisht të njëjta sikurse rrethanat faktike dhe baza ligjore mbi bazën e të cilave është nxjerrë Vendimi me numër Ref: 411/2022 i datës 30.06.2022 përmes të cilit ankuesit është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Përfaqësuesit e autorizuar të palëve kundër Vendimit të Këshillit me numër A.nr.365/2022 të datës 10.06.2022 kanë parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit me datë 05.07.2022 ka nxjerrë Aktvendimin A.nr.1687/2022 përmes të cilit e ka shpallur vetën jo kompetent në pikëpamje të kompetencës lëndore, ndërsa pasi që i njëjti aktvendim të merr formë të prerë, lëndën do ta përcjellin në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Divizionit Civil, mirëpo përfaqësuesi i palëve paditëse kundër Aktvendimit A.nr.1687/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me datë 28.07.2022 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Gjykatat e Apelit të Kosovës përmes Aktvendimit 597/2022 të datës 25.08.2022 ka vërtetuar Aktvendimin A.nr.1687/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa e ka refuzuar ankesën e palëve paditëse. Palët paditëse kundër Aktvendimit A.nr.597/2022 të datës 25.08.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës kanë parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme, kurse kjo e fundit me datë 09.11.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me shifër ARJ-UZVP.nr.115/2022 përmes të cilit i ka prishur Aktvendimin A.nr.1687/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktvendimin A.nr.597/2022 të datës 25.08.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës ndërsa lëndën e ka kthyer për shqyrtim të mëtutjeshëm në shkallën e parë.

Duke vepruar sipas Aktgjykimit me shifër Arj-UZVP.nr.115/2022 të Gjykatës Supreme, të datës 09.11.2022, Gjykata Themelore në Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative me datë 22.03.2023 ka nxjerrë Aktvendimin A.nr.1687/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes të cilit vendim e ka refuzuar kërkesën e palëve paditëse për mosekzekutimin e vendimit të Këshillit deri në nxjerrjen e vendimit meritore të procesit gjyqësor.

Meqenëse në Gjykatën Themelore në Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative është e duke u trajtuar meritorisht Vendimi A.nr.365/2022 i datës 10.06.2022 i Këshillit për çështje të njëjta sikurse të kësaj lënde sipas pikëpamjeve juridike të Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku Këshilli ishte shpallur jo kompetentë për të shqyrtuar ankesat e ankuesve të cilëve iu ishte ndërprerë marrëdhënia së punës nga ana e Zëvendës/Kryeministres dhe Ministres së Punëve të Jashtme janë specifikisht të njëjta sikurse rrethanat faktike dhe baza ligjore mbi bazën e të cilave

është nxjerrë Vendimi me numër Ref: 411/2022 i datës 30.06.2022 përmes të cilit ankuesit

i është ndërprerë marrëdhënia e punës, andaj Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit", konstaton se ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që shqyrtimi i lëndës A.nr.622/2022 të pezullohet deri në vendosjen meritorisht nga Gjykata Themelore në Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative sipas pikëpamjeve juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që objekti i shqyrtimit (ndërprerja e marrëdhënies së punës duke iu referuar procedurave të rekrutimit sipas konkursit të datës 22.07.2011 të shpallur nga MPJ) respektivisht baza ligjore dhe rrethanat mbi të cilat është nxjerrë Vendimi i datës 30.06.2022 me Ref: 411/2022 nga Zëvendës/Kryeministrja dhe Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë të njëjta dhe shërben si parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, pas vendosjes së rastit nga Gjykata Themelore në Prishtinës-Departamenti për Çështje Administrative dhe përfundimit të çështjes në instanca gjyqësore, Këshilli sipas detyrës zyrtare do të aktivizojë dhe do të vendos edhe për lëndën A.nr.622/2022 të ankuesit e datës 15.07.2022.

Prandaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të provave të lëndës dhe konstatimeve të dhëna si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.1128/2023

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivot të KPMSHCK-së.